



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 47-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 10.09. 2021, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Mehmetali Krasniqi, anëtar
3. Fitim Shala, anëtar
4. Fadil Sopa, anëtar
5. Hyra Bytyçi, anëtare
6. Naim Jahiri, anëtar
7. Naim Stullca, anëtar
8. Majlinda Sylejmani, anëtare
9. Ramadush Tasholli, anëtar
10. Arif Miftari, anëtar
11. Fatime Krasniqi, anëtare
12. Xhyzide Rrustemi, anëtare
13. Lulzim Rrustemi, anëtar
14. Ramiz Qeriqi, anëtar
15. Egzona Bytyqi, anëtare
16. Nazmi Krasniqi, anëtar
17. Lumturije Bytyqi, Hasani, anëtare
18. Shkelzen Bislimi, anëtar
19. Albulena Kelmendi, anëtare
20. Alban Salihu, anëtar
21. Afrim Miftari, anëtar
22. Hajdin Bytyqi, anëtar
23. Safete Amerllahu, anëtare
24. Bashkim Budakova, anëtar
25. Ukë Kryeziu, anëtar
26. Ganimete Qeriqi, anëtare
27. Manush Shamolli, anëtar
28. Fehmi Rexhepi, anëtar
29. Argjend Tasholli, anëtar

30. Egzona Fazlija, anëtare
31. Arben Salihu, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Fauz Xhemajli, Nënkyetar i Komunës
3. Latif Ramadani DBF
4. Valon Pacolli, DA
5. Bekim Shabani, DEZH
6. Merita Bytyqi, DSH
7. Dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit tha së pari ju uroj të jeni mirë dhe të keni shëndet. Pastaj tha si duket kjo do të jetë mbledhja e fundit e Kuvendit për këtë mandat ku ju falënderoj te gjithëve për bashkëpunimin që kemi pasur, po ashtu kandidatëve për asamble komunale ju uroj suksese.

Pastaj tha se në mbledhje prezantojnë shumica e anëtarëve të Kuvendit; Rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. **Aprovimi i ekstrakteve nga mbledhja e 45 dhe e 46(e jashtëzakonshme)**
2. **Propozim Vendim mbi aprovimin e buxhetit për vitet 2022-2024**
3. **Propozim vendim për ndarjen e mjeteve financiare (Caritasi-Zvicrran)**
4. **Propozim vendim për ndarjen e mjeteve financiare**

Pastaj kryesuesi pyeti anëtarët e kuvendit se a ka vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës

Meqë vërejtje as plotësime nuk pati, Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 29 vota për, aprovoi rendin e ditës së propozuar.

Pastaj u kalua në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Ramiz Qeriqi,se pari ju uroj suksese atyre qe janë ne garë. Kam një kritike për ekzekutivin, nëse nuk ndërrohet kockat e trotuarit përballe komunës te cilat janë te thyera unë do ta padisë komunën.

Lulzim Rrustemi,se pari ju falënderoj për bashkëpunim qe kemi pasur gjate këtij mandati. Kam disa pyetje e para lumi janjevka kur pritet me filluar rregullimi tina. Rrugët ne Rufc te vjetër kur pritet me filluar me u asfaltuar. Pse nuk e kemi ne këtë mbledhje te kuvendit raportin e Auditorit te përgjithshëm.

Fauz Xhemajli, shume shpejt pritet te fillojnë punimet, edhe te lumi janjevak edhe ne Rufc rrugicat, ndërsa sa i përket rrugës përballe komunës ende nuk ka përfunduar.

Pastaj u kalua me punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstrakteve nga mbledhja e 45 dhe e 46(e jashtëzakonshme).

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilin i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati Kryesuesi vuri në votim ekstraktin nga mbledhja e 44 të e Kuvendit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 29 vota për

Aprovoi

Ekstraktit nga mbledhja e 45 dhe e 46(e jashtëzakonshme).

Shtesë: Ekstrakti.

II.

Propozim Vendim mbi aprovimin e buxhetit për vitet 2022-2024

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadani drejtor DBF, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani, me vjen mirë që një pjesë e propozimeve tona gjatë dëgjimeve buxhetore janë përfshi në këtë buxhet. Çerdhja në Shalë është përfshi por nuk po shoh Qendrën Rinore në Shalë. Po ashtu në këtë buxhet nuk e kam par që janë të përfshimë lapidaret.

Lulzim Rrustemi, një buxhet i detajuar por ka mundur të jeni më mirë. Në përgjithësi janë shku mjetet në asfalt ndriçim publik. Disa projekte kanë mbete në gjysmë nuk e di pse. Rruga Janjeve Brus është dashtë të përfshihet në këtë buxhet. Po ashtu është dashtë të ket më shumë hapësira të gjelberta të investohet në shëndetësi, të ketë kënde të lojrave.

Latif Ramadani, qendra rinore në Shalë do të behet të zyrë e ofiqarisë aty është një pjesë e lire. Lapidarët nuk i kemi përfshi. Ndërsa rruga Brus- Janjevë kemi aplikuar në ministri.

Megjë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 21 vota për 7 kundër dhe 2 abstenime aprovoi.

Shtesë:Vendimi.

III

Propozim vendim për ndarjen e mjeteve financiare (Caritasi-Zvicrran)

.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadani drejtor i DBF-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Megjë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 29 vota për, aprovoi:

Shtesë:Vendimi.

IV

Propozim vendim për ndarjen e mjeteve financiare

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadani drejtor i DBF-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 28 vota për, aprovoi:

Shtesë:Vendimi.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 11,⁰⁰

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi